



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-073

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2014
PËR PROJEKTIN E HUASË**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2014 PËR PROJEKTIN E HUASË**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 për Projektin e Huasë.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 për Projektin e huasë, e lidhur më 08.09.2015, në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në Shtojcën nr. 1 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 për Projektin e Huasë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-073
24 shkurt 2016

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI